

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fjalimi i Ramës në OKB/ Berisha: Ai është armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër Vetëvendosjes
ADRESA	https://dosja.al/politike/fjalimi-i-rames-ne-okb-berisha-ai-eshte-armik-i-eger-i-kosoves-tani-po--i516139
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 10:47:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 10:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6ba0a3aaf578ca9a6a52df10b9296f063f8e3641f9e824588a5a1e6ba2d9f593
TEKSTI	0cffe5baa5fc761bd228267f5aedd864056ec893ac64fb8f03f30e02ffde6101
PAMJA	4795173aec8c1adaae241f857d456377e8cb5832eeb3b338ba1728ca984ac4c3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ca27bbb047f5877b26837554a17ed3ce17aeac11bc94b48b8874243ca920ef01
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/ca27bbb047f5877b26837554a17ed3ce17aeac11bc94b48b8874243ca920ef01

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

9 MINUTA ME PARE

Zyrtarisht në detyrë/ Eric Wendt dorëzon letrat kredenciale, nis misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri

28 MINUTA ME PARE

SPAK aksion në Shkodër e Tiranë/ Goditet grupi kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)

16 ORE ME PARE

"Shqipëria po përjeton të ardhmen që të tjerët ende po e diskutojnë"/ Rama nga OKB: Algoritmi aktivizoi urrejtjen, qytetarët protestuan kundër një armiku imagjinar izraelit

17 ORE ME PARE

Dita e 118-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

Politike

Fjalimi i Ramës në OKB/ Berisha: Ai është armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër Vetëvendosjes



26 Shtator 2026, 12:35
Nga DOSJA



Sali Berisha

"Fjala e Padrinos në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ishte fjala më e turpshme që është mbajtur ndonjëherë pas fjalimeve të ministrave të jashtëm të Shqipërisë apo atyre të Koresë së Veriut. Nuk kemi pasur kurrë një përfaqësim kaq të turpshëm, ku kreu i narkoshtetit shqiptar, i fandaksur, i tmerruar nga protesta rinore, qytetare dhe skandalet e njëpasnjëshme, i kushtoi fjalën e tij algoritmit dhe tmerrit që ndjen nga algoritmi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Në këtë fjalim, në atë sallë e cila jo rastësisht, por në një akt përcërimi madhor ishte bosh gjatë fjalës së tij, Edi Rama nuk shqiptoi një herë të vetme fjalën Kosovë dhe fjalën UÇK apo lider të UÇK-së. Tradhtia i ka zënë grykën. E ka mbërthyer për grykë dhe nuk e lejon më të shqiptojë një fjalë. Histori e turpshme. Në atë sallë, në një fjalim të shkëlqyer, kryeministri i vendit mik, Kroacisë, foli sikur të ishte kryeministri i Shqipërisë.

Ai denoncoi veprimet e Beogradit, nderimet ushtarake që i bëhen monstrove të gjenocidit të Bosnjës, Ratko Mlladiç, përpjekjet destabilizuese të Beogradit në Kosovë dhe për probleme të tjera të rajonit. Kurse për Edi Ramën, universi i tij ishte algoritmi, që në fakt i ka kallur tmerrin dhe datën në çdo qelizë të tij. Por, me këtë rast, i ftoj edhe ata pak qytetarë të Kosovës që për jugosllavizmin e tyre, apo për të mbetur si relike, apo për enverizmin e tyre, vazhdojnë dhe bëjnë të mashtruarin nga Edi Rama. Të gjithë ata që duan Kosovën, panë dhe kanë parë me dokumente, fakte të pakundërshtueshme se Edi Rama është një armik i egër i Kosovës, i demokracisë. Miq, pas përpjekjeve për të rrëzuar qeverinë e Kosovës me Vlora Hysenin dhe të dërguarit e tij, ai po përhap tani në Shqipëri shpifjet më të ulëta me të cilat kërkon të paraqesë Lëvizjen Vetëvendosje si një parti kundra Shqipërisë. Unë u them këtyre puthadorëve të Edi Ramës, që paguhen si shërbëtorë të tij dhe kalojnë nga një studio në një studio tjetër me një mashtrim të paskrupullit, në Kosovë e vërteta është se nuk ka asnjë parti anti-Shqipëri.

Por ka një krve ministër në Shqipëri anti-shaiptar. Ka një krve ministër në Shqipëri. o cakei dhe outhadorë aë ka

editoriale

Auron Janku
"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli
Shqipëria, socializmi i Edi
Ramës pa të majtën

Në vëmendje

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:36

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës



AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:14

U arrestua nga SPAK gjatë operacionit "Muri i Lartë"/ Kush është Bledar Çafi, "i forti" i Shkodrës ndër vite i përfshirë në botën e krimit



ndërtuar në vendin amë, në Shqipëri, shtetin e drogës dhe ju paguan ju. Si mund ta akuzoni një parti sot në qeverinë e Kosovës se qenka kundra Shqipërisë? Nuk ka asnjë parti në Kosovë kundra Shqipërisë, por natyrisht çdo shqiptar i ndershëm në Kosovë dhe kudo në botë është kundër narkoshtetit të Edi Ramës, dhe ju përdorni Shqipërinë si mburojë për narkoshtetin e Edi Ramës.

Turpi ju mbuloftë! Nuk ka asnjë parti anti-Shqipëri në Kosovë, por ka një shqiptar që sillet si Pashiçi i Serbisë ndaj Kosovës, një shqiptar që quhet Edi Rama, argati i Vuçitit. Ju që dilni në studio o të pafytyrë dhe etiketoni anti-shqiptare partitë e Kosovës, harroni ju sanksionet që vuri kundër Kosovës i pari në Evropë? Harroni ju xhiron ballkanike që bëri për të izoluar kryeministrin e Kosovës, ndërkohë që të tjerët i tregonin bërryllin, për kërkesën e tij, fqinjët e tjerë? Harroni ju se si dorëzoi projektin e copëtimit të Kosovës? Harroni ju se si dorëzoi projektin e marrë në Beograd për Asociacionin?

Se si kërkoi konferencën ndërkombëtare për Kosovën në mënyrë që rusët të uleshin në tavolinë? Si i lejoni vetes një gjë të tillë? Ju me të njëjtin zell, të njëjtin shërbim i shërbeni Vuçitit. Ju jeni po kaq anti-shqiptarë sa Edi Rama, i cili s'guxon të përmendë fjalën Kosovë në OKB. I cili nuk tha një fjalë të vetme për dënimin e tërë asaj udhëheqjes politike të Kosovës. Nuk shqiptoi një fjalë të vetme. Nuk ekzistonte për Edi Ramën ky problem. Ky apatrid gjeti të bëhej patriot në një darkë ku sulmoi për tradhti Shtetet e Bashkuara dhe presidentin Joe Biden. Joe Biden sot nuk është president, por u them shqiptarëve që në të gjithë karrierën e tij politike ai, qëndrimin dhe votën e ka patur për shqiptarët. Dhe del një zuzar dhe thotë se tradhtoi Joe Biden, meqenëse ai tani nuk është më në funksione. Tradhtoi Amerika, Hashim Thaçin. Si mund të shqiptohet një fjalë e tillë?

Me çfarë e tradhtoi Amerika Hashim Thaçin, a thoni pak njëherë? Se çliroi Kosovën në bashkëpunim me UÇK-në? Pra, praktikisht, ky Padrino i degraduar sot nuk ka asnjë interes tjetër vetëm karrigen e tij sepse e di që po i vjen fundi, fundi dhe fund i tmerrshëm. Pse i tmerrshëm do thoni ju? Sepse ka firmosur në qindra vendime anti-ligjore. Sepse është de facto drejtues i kartelevë më të fuqishme të drogës në Evropë dhe ndër më të fuqishmet në botë. Sepse ka vjedhur miliarda në tendera, prokurime dhe pasuri publike. Nuk ka sot Evropa një të dytë të inkriminuar si Edi Ramën. Ndaj dhe ai, jeni të përgatitur të dëgjoni çdo gjë gjersa të përfundojë në sallën e gjyqit," tha Berisha./Dosja.al

sali berisha

Sondazh

Poll

Politike

26 Shtator 2026, 12:25

Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan, Berisha: Dëshmuan se orteku i opozitës po rritet çdo ditë dhe do të përmbushë misionin e tij

"Së dyti, këtë javë ishte java e turpit të Shqipërisë në OKB, ku përfaqësuesi i narkoshtetit bëhet kreu..."

Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për tu dhënë rastin bashkëpunëtorëve të vet që

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 10:55

VIDEO/ Operacioni i SPAK në Shkodër, momenti i arrestimit të 50-vjeçarit me rrezikshmëri të lartë, Bledar Çafi

më të klikuarat

VIDEO/ Pamje të rënda nga atentati në Sarandë! Artan Myrtaj vrapon për tu shpëtuar plumbave, autorët e ndjekin dhe qëllojnë në mes të rrugës

Vrasja e 'Tanit të Rruzhdit' në Sarandë, dalin fotot e autorit në momentin e ekzekutimit

Nga karriera e gjatë diplomatike dhe ushtarake tek posti si ambasador në Shqipëri/ Gazeta amerikane: Eric Wendt vjen në Tiranë mes protestave masive kundër qeverisë

Këshilli Bashkiak i Tiranës kërkon Erion Veliajn në mbledhje, kërkesë SPAK-ut: Nëse nuk është e mundur fizikisht të lejohet online

insights

Bledian Koka

I vetmi Kryeminister!

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by  tomorrow.

me të cilat bashkëpunohet në fjalë
e tradhtuan

Politike

26 Shtator 2026, 12:16

Eric Wendt mbërrin në Pallatin e
Brigadave, dorëzon letrat kredenciale

Politike

26 Shtator 2026, 11:07

Pas thujse 3 vitesh, SHBA me një
ambasador në Shqipëri/ Eric Wendt nis
sot detyrën në Tiranë pas dorëzimit të
letrave kredenciale

Politike

26 Shtator 2026, 08:07

"Prania besnike e Edi Ramës dhe Erion
Braçes"/ Aktivistja përplasat me
deputetin: Qeverisë tuaj duhet t'i vijë turp
që ka guxim të dalë përballë qytetarëve

Politike

25 Shtator 2026, 22:40

Politike

25 Shtator 2026, 22:00

Rama zhgënjën Kosovën në OKB/ Flet për Inteligjencën Artificiale dhe nuk përmend dënimin e ish-krerëve të UÇK-së

Edi Rama KOSOVA- Kryeministri Edi Rama zhvilloi këtë mbrëmje
fjalimin e tij në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ku fo...

Zgjedhja e Presidentit të Kosovës/ PDK
ndryshon qëndrim: Jemi në rrethana të
reja

Politike

25 Shtator 2026, 21:44

Deklarata për Gjykatën Speciale, Kuvendi i Kosovës mblidhet të hënën

Politike

25 Shtator 2020, 21:22

"Këtu mbaron predikimi im në shkretëtirë" / Rama mbajti fjalimin në OKB, salla pothuajse bosh (VIDEO)

Politike

25 Shtator 2020, 21:14




"Shqipëria ka zgjedhur novacionin" / Rama: Pa një botë të përbashkët nuk mund të ketë Kombet e Bashkuara

Politike

25 Shtator 2020, 20:05

MË SHUMË



Aktivistja përplasat me deputetin: Qeverisë tuaj duhet t'i vijë turp që ka guxim të dalë përballë...

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.